

STATUT I SHOQËRISE
ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“ENERGY DEVELOPMENT PARTNERS” SH.P.K.

KREU I
DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 1

Ortakët

Shoqëria është themeluar nga ortakët:

- i.* **Z. Realdo Mansaku**, shtetas shqiptar, lindur me 31.03.1987, ne Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit me Nr. 033575520, madhor dhe me zotësi te plote juridike për te vepruar;
- ii.* **Z. Florian Mitrushi**, shtetas shqiptar, lindur me 07.04.1984, ne Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit me Nr. 034041333, madhor dhe me zotësi te plote juridike për te vepruar;

Neni 2

Emërtimi

Emri i shoqërisë është **“ENERGY DEVELOPMENT PARTNERS” sh.p.k.** (ne vijim referuar si **“Shoqëria ”**).

Neni 3

Selia e Shoqërisë

- 3.1 Selia e Shoqerise do te jete ne adresen: *Rruga “Sami Frasheri”, Nd. 19, H.8.*
- 3.2 Shoqëria mund te hapë hape dhe/ose mbylle dege, agjenci dhe/ose zyra perfaqesimi brenda apo jashtë territorit te Republikës se Shqipërisë.

Neni 4

Forma juridike

Shoqëria është një Shoqëri tregtare me përgjegjësi te kufizuar (Sh.p.k.), e themeluar sipas legjislacionit shqiptar të ligjit të Republikës së Shqipërisë.



Neni 5

Kohëzgjatja

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj tregtar për një kohëzgjatje të pacaktuar, nisur nga data e themelimit deri në prishjen ose likuidimin e saj.

Neni 6

Objekti i aktivitetit

- 6.1 Objekti i aktivitetit të Shoqërisë do të konsistoj në të gjitha llojet e aktiviteteve sipas klasifikimit kombëtar të aktiviteteve, përveç atyre aktiviteteve për të cilat kërkohet miratimi ose akti i një organi shtetëror ose organi të autorizuar.
- 6.2 Fusha kryesore e aktivitetit do të jetë:
- ❖ Projektimi, ndertimi, zhvillimi, vënie në punë e mirëmbajtjen e impianteve për prodhimin e energjisë së rinovueshme (dielli, era, uji, biomasa etj) dhe jo-te rinovueshme në Shqipëri dhe jashtë saj, ndërmjet përmarrjes së tendera dhe/ose nëntendera nga ente publike dhe/ose private, nëpërmjet përmarrjes së gare për dhenien e koncesionit dhe të tjera si këto, prodhimin, shpërndarja, tregtimi ose shitjen e ente publike dhe/ose private të energjisë;
 - ❖ Planifikimin, ndertimin, operimin, menaxhimin dhe financimin e furnizimit të decentralizuar të energjisë;
 - ❖ Importimi dhe prodhimi i pajisjeve teknike në fushën e teknologjisë së përmendur këtu duke përfshirë co- gjeneratorët dhe teknologjitë të tjera për të prodhuar energji.
 - ❖ Ofrimi i shërbimeve inxhinierike për teknologjinë e nevojshme për fushat e përmendura më sipër.
 - ❖ Ndërtim, projektim hidrocentralesh studime të fizibilitetit, planit të biznesit. Monitorim dhe operonance të përgjithshme, verifikim i parametrave teknike, socialmjedisore, dhe ligjore për hidrocentralet e vegjël, të mesëm dhe të mëdhenj. Mbikqyrje e zbatimit të punimeve për hidrocentralet e vegjël, të mesëm dhe të mëdhenj. Centrale termike (primare, sekondare). Impiante të prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike - diellore -era etj. Nënstacione elektrike, primar sekondar - linja të tensionit të lartë. Kabina elektrike të rrjetit shpërndarës - linja të tensionit të ulët - të mesëm. Ushtrim i veprimtarisë financiare të faktoringut si subjekt jo financiar.
 - ❖ Përgatitje e studimeve të fizibilitetit, planeve të biznesit për fushën e cituar më sipër dhe në teresi.
 - ❖ Shërbime konsulente dhe asistencë administrative në sektorin e përmendur më sipër si edhe në çdo aktivitet tjetër që ka të bëjë me një përdorim më të mirë në vlerësimin e strukturave, e burimeve e kompetencave të kryera në sektorin e mësipërm.
 - ❖ Këshillime për bizneset, konkretisht këshillime në fushën bankare, këshillime të sigurimit të llojeve të ndryshme, këshillime për financime të ndryshme, modelim i biznesit, këshillime mbi



ristrukturimin e organizimin financiar, studime tregu, studime plan biznesi, keshillime ne fushen e tatim taksave.

- ❖ Analiza per industri te ndryshme, analizim i strukturave operative financiare duke perfshire ketu analizim i performances se Shoqerise duke konsdiderua industrine qe operon. Analiza dhe vleresim te biznesit, keshillime mbi transaksionet e shtjeve dhe analiza per strategjine e shitjeve, keshillime mbi partnership-e te ndyshme dhe negocime te termave te mareveshjeve.
- ❖ Keshillime mbi vleresimin e aseteve te Shoqerive dhe te aseteve njerezore, asistim ne pergatitjen e raporteve vjetore, vleresime risku dhe keshillime per mitigimin e tyre.
- ❖ Ristrukturime te bizneseve ne veshtiresi, keshillime dhe asistence ne marredheniet me institucionet financiare, keshillime dhe bashkepunime me dhe per sektorin publik.
- ❖ Tregtimi i pjeseve te kembimit dhe aksesoreve per autovetura, kamione dhe motocikleta, Import, eksport, tregtim i automjeteve.
- ❖ Te gjitha aktivitetet e biznesit te cilat direkt ose indirekt mund te sherbejne per objektin e veprimtarise se saj.

PJESA II

KUOTAT DHE KAPITALI I SHOQËRISË, ZMADHIMI DHE ZVOGELIMI I TIJ

Neni 7

Kapitali i Shoqërisë

- 7.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është 1000(një mijë) LEKE. Kapitali i shoqërisë përbëhet nga 2 (dy) kuota me vlerë nominale secila prej 500 (peseqind) LEKE përkatësisht.
- 7.2 Pjesëmarrja e ortakëve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin e tyre si më poshtë:
- i. **Z. Realdo Mansaku**, në cilësinë e ortakut themelues, është zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 500 (peseqind) LEKE që përbën 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë;
 - ii. **Z. Florian Mitrushi**, në cilësinë e ortakut themelues, është zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 500 (peseqind) LEKE që përbën 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Neni 8

Transferimi i kuotave

- 8.1 Kuotat e kapitalit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
 - b) shitblerjes;



- c) trashëgimisë;
 - d) dhurimit;
 - e) Çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.
- 8.2 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.
- 8.3 Në rast tjetërsimi të kuotës nga një prej ortakëve jashtë strukturës së shoqërisë, ortaku tjetër gëzon të drejtën e parablerjes. Me “*tjetërsim*” do të kuptohet çdo akt kalimi i kuotave, në kuptimin me të gjere të fjalës, si në pronësi të plote ashtu dhe të pjesëshme, që, në mënyre direkt apo indirekte, sjell ndryshimin e pronësisë mbi kuotat ose të drejtat mbi to.
- 8.4 Ortaku që synon të tjetërsojë, tërësisht ose pjesërisht, kuotat e tij në kapitalin themeltar duhet t’i komunikojë ortakut tjetër me shkrim, ofertën e marre, duke treguar emrin e blerësit të mundshëm dhe kushtet e tjetërsimit, në mënyrë të veçante çmimin e përcaktuar dhe mënyrën e pagesës (në vijim referuar si “**Oferta**”).
- 8.5 Brenda 30 (*tridhjetë*) ditëve nga marrja e komunikimit të Ofertës, ortaku/et interesuar në ushtrimin e së drejtës së parablerjes duhet t’i komunikojnë ortakut që kalon të drejtat mbi kuotat, dëshirën për të ushtruar të drejtën e parablerjes, përpjesëtimisht me pjesëmarrjen e secilit në kapitalin themeltar dhe sipas kushteve të Ofertës, duke shprehur edhe interesin e mundshëm për blerjen e pjesës së kuotave për të cilën nuk është ushtruar e drejta e parablerjes nga ana e ortakëve të tjerë. Është i pavlefshëm çdo komunikim që nuk përmban të gjitha të dhënat e mësipërme.
- 8.6 Nëse e drejta e parablerjes nuk ushtrohet brenda afateve të mësipërme, ortaku ofruar mund t’i transferojë kuotat e veta në favor të blerësit të treguar (personit të tretë) në komunikimin e Ofertës dhe në kushtet e parashikuara në të.
- 8.7 Në rast tjetërsimi të kuotave në favor të të tretëve, pa zbatuar dispozitat e parashikuara më sipër, blerësi nuk do të legjitimohet në ushtrimin e të drejtave administrative dhe pasurore dhe tjetërsimi i kuotave nga ana e tij nuk do të prodhojë efekte ndaj shoqërisë dhe ortakut/eve të tjerë.

Neni 9

Zmadhimi i kapitalit themeltar

- 9.1 Kapitali i themeltar mund të zmadhohet në çdo kohë, në një ose me shumë këste, në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.
- 9.2 Zmadhimi i kapitalit të Shoqërisë mund të kryhet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë.
- 9.3 Zmadhimi i kapitalit mund të vendoset kur e kërkojnë interesat e Shoqërisë duke vendosur kuotat suplementare të Ortakëve.



Neni 10

Zvogëlimi i kapitalit themeltar

- 10.1 Shoqëria mund te zvogëlojë kapitalin themeltar, me vendim te Asamblesë se Përgjithshëm te Ortakeve ne përputhje me legjislacionin ne fuqi. Ne çdo rast, kapitali themeltar nuk mund te zvogëlohet nën vlerën 100 (njëqind) LEKE, pra nen minimumin e përcaktuar ne ligj.
- 10.2 Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.
- 10.3 Zvogëlimi i kapitalit nuk duhet të dëmtojë kreditorët e as të krijojë pasiguri tek ata që kanë dhënë kredi para publikimit të zvogëlimit të kapitalit. Në të kundërtën Gjykata e konsideron të pavlefshëm këtë vendim mbi kërkesën e kreditorëve.

PJESA IV

ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

Neni 11

Të drejtat e asamblesë së përgjithshme

- 11.1 Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë e cila ka të drejtë të marrë vendime në lidhje me të gjitha çështjet e veprimtarisë së shoqërisë (ne vijim referuar si “Asambleja e Përgjithshme”).
- 11.2 Asambleja e Përgjithshme përbëhet nga të gjithë ortakët e Shoqërisë.
- 11.3 Vetëm Asambleja e Përgjithshme ka të drejtë të vendosë për sa më poshtë:
 - a. ndryshime dhe modifikime të Statutit;
 - b. pranimin e ortakëve të rinj;
 - c. largimin/përrjashtimin e një ortaku, në përputhje me dispozitat statutore në fuqi;
 - d. zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit dhe/ose çdo lloj pagimi të pjesshëm ose financim të dhënë nga ortakët;
 - e. ndryshimin e formës se shoqërisë ose ristrukturimin e saj;
 - f. blerjen apo disponimin e interesit pjesëmarrës në shoqëri shqiptare apo të huaja;
 - g. hapjen dhe mbylljen e degëve dhe zyra e përfaqësimit;
 - h. miratimin e raporteve vjetorë dhe bilancit të Shoqërisë si dhe shpërndarjen e fitimit;
 - i. blerjen, shitjen dhe lenia ne hipotekë të pasurive të paluajtshme;
 - j. të japë letra me vlerë, të marrë detyrime, të lëshojë garanci.
 - k. të përcaktojë parimet e përgjithshme të politikave të shoqërisë;
 - l. të caktojë shpërblimet për administratorit/eve, të përfundojë marrëdhënien kontraktore me administratorin/ët dhe nëpunësit ekzekutivë të shoqërisë;



- m. të zgjedhë alternativa, te drejta, të ndarjes së fitimit vjetor, pagesave në natyrë, të drejtat mbi pensionet ose çdo pagese mbi largimin e drejtorëve, dhe nëpunësve ekzekutivë të shoqërisë;
- n. emërimin, shkarkimin dhe zëvendësimin e likuiduesve, ekspertëve kontabël te autorizuar;
- o. të ngre padi kundër anëtarëve të organeve të shoqërisë ose kundër ortakëve të tjerë;
- p. te përfaqësoj Shoqërine në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorit/ëve;
- q. përcaktimin e strukturës organizative dhe administrative të Shoqërisë;
- r. përcaktimin e buxhetit vjetor;
- s. miratimin e çdo çështje tjetër zgjidhja e së cilës i është rezervuar Asamblesë së Përgjithshme te ortakeve në përputhje me ligjin dhe këtë Statut.

Neni 12

Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme

- 12.1 Vendimet qe kane si objekt zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar të Shoqërisë do të merren vetëm nëpërmjet miratimit unanim të të gjithë ortakëve të cilët zotërojnë 100 (njëqind)% të kuotave të Shoqërisë.
- 12.2 Vendimet për miratimin e të cilave kërkohet një shumicë e kualifikuar, në përputhje me dispozitat e legjislacionit ne fuqi, do të konsiderohen të vlefshme vetëm nëse do të miratohen nga tre të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës dhe në votim kanë marrë pjesë ortakët me të drejtë vote që zotërojnë më shumë se 50 (pesëdhjetë)% të kuotave.
- 12.3 Vendimet për miratimin e të cilave kërkohet një shumicë e zakonshme, në përputhje me dispozitat e legjislacionit ne fuqi, do të konsiderohen të vlefshme vetëm nëse do të miratohen nga shumica e votave të ortakëve pjesëmarrës dhe në votim kanë marrë pjesë ortakët me të drejtë vote që zotërojnë më shumë se 30(tridhjetë)% të kuotave.

Neni 13

Thirrja e Asamblesë së Përgjithshëm

- 13.1 Asambleja e përgjithshme do të thirret dhe mbahet nga administratori të paktën njëherë në vit në selinë e Shoqërisë ose ne çdo vend tjetër nëse përcaktohet ne njoftim e mbledhjes.
- 13.2 Ortakët të cilët përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave ne aAamblenë e Përgjithshme mund t'i drejtojnë administratorit një kërkesë me shkrim ose nëpërmjet postës elektronike për të thirrur asamblenë e përgjithshme. Në kërkesën drejtuar administratorit mund të përfshihen dhe çështjet e posaçme të rendit të ditës.
- 13.3 Asambleja e Përgjithshëm do të thirret me anë të një njoftimi të shkruar të dërguar nga administratori, njoftim ky i cili duhet të merret nga përfaqësuesit e ortakëve, jo më pak se 7 (shtatë) ditë përpara datës së caktuar të mbledhjes. Gjithashtu, asambleja e përgjithshme mund të thirret nëpërmjet postës elektronike me të njëjtat kushte dhe afate.



- 13.4 Njoftimi për takimin e Asamblesë së Përgjithshme do të tregojë datën kohën dhe vendin e takimit si dhe çështjet e rendit të ditës.
- 13.5 Nëse data për mbledhjen e ardhshme të Asamblesë se Pergjithshme është vendosur në takimin e fundit dhe të gjithë ortakët kanë qenë prezentë, atëherë do të gjykohet sikur njoftimi është dërguar.
- 13.6 Ne rast mosrespektimi te formaliteteve te mësipërme, Asambleja do te konsiderohet e thirrur rregullisht vetëm nëse është e përfaqësuar tërësia e kapitalit themeltar.
- 13.7 Nëse mbledhja e asamblesë se përgjithshme thirret në mënyrë të rregullt por nuk plotësohet numri i ortakëve të caktuar për të përmbushur kuorumin, atëherë asambleja do të thirret përsëri në përputhje me parashikimet e këtij Neni dhe gjithmonë jo më vonë se 30 ditë me të njëjtin rend dite.

Neni 14

Procesverbalet e Asamblesë së Përgjithshme

- 14.1 Të gjitha vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratori përgjigjet për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të Asamblesë së Përgjithshme. Procesverbali duhet të përmbajë datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit si dhe ti bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes së Asamblesë së Përgjithshme.
- 14.2 Procesverbali i Asamblesë së Ortakëve nënshkruhet nga të gjithë ortakët pjesëmarrës në Asamblenë e Ortakëve kur ata mblidhen fizikisht. Kur mbledhja kryhet me telekonference atëherë Procesverbali nënshkruhet nga Kryetari.

PJESA V

ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

Neni 15

Administrimi i Shoqërisë

- 15.1 Administrimi i shoqërisë do të bëhet nga një administrator, i cili do te përfaqësojë individualisht Shoqërinë.
- 15.2 Administratori mund të autorizojë palë të treta që t'i përfaqësojnë ata në transaksione të veçanta.
- 15.3 Administratori do të organizojë dhe menaxhojë të gjithë aktivitetin e Shoqërisë, nën tutelën e Asamblesë së Përgjithshme. Ai është i autorizuar të përfaqësojë Shoqërinë në të gjitha çështjet që kanë lidhje me të.
- 15.4 Të drejtat dhe detyrimet e administratorit burojnë nga ligji, ky Statut, vendimet e Asamblese se Pergjithshme dhe rregullat e brendshme të administrimit të Shoqërisë.
- 15.5 Administratori ka të drejtat dhe detyrimet e mëposhtme:
- a.* përfaqësimin e Shoqërisë kundrejt palëve të treta dhe ne gjykate;



- b. hapjen e llogarive bankare të Shoqërisë me bankat;
- c. përfundimin e marrëveshjeve me palët e treta, lëshimin dhe marrjen e urdhër pagesave;
- d. nënshkrimin e të gjithë dokumenteve, nxjerrjen e faturave, transferimet në monedhë të huaj, fletë ngarkesat etj, pagimin e detyrimeve të Shoqërisë dhe pranimin e letrave me vlerë nga palët e treta;
- e. mbledhjen e detyrimeve që i takojnë shoqërisë;
- f. punësimin dhe shkarkimin e stafit të Shoqërisë, përcaktimin e pagave, shpërblimeve dhe pagesave të stafit;
- g. marrjen e masave paraprake për mbrojtjen e interesave të Shoqërisë, fillimin e padive dhe marrjen përsipër të mbrojtjes së Shoqërisë në rast të padive kundër saj; administratori mund të udhëzojë avokatët të mbrojnë Shoqërinë dhe mund të përcaktojnë shumën e shpërblimit të tyre; administratori ka të drejtë të ngri padi dhe t'a tërhiqi atë, të nënshkruajë marrëveshje gjyqësore, të mbylli marrëveshje arbitrazhi, të caktojë arbitra, të tërheqë paditë e ngritura nga Shoqëria dhe të ndërpresë procedimet;
- h. marrjen e çdo vendim tjetër që i takon aktivitetit të përditshëm të Shoqërisë nga pikëpamja e ligjit dhe këtij Statuti;
- i. mbajtjen e llogarive në përputhje me ligjin dhe parimet e ligjit;
- j. përgatitjen e pasqyrave vjetore financiare të Shoqërisë dhe kontrollin e tyre nga auditorë të jashtëm nëse kjo kërkohet nga ligji ose nga një vendim i Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve;
- k. thirrjen e mbledhjeve të ortakëve; përcaktimin e rendit të ditës; monitorimin e përmbushjes së dispozitave që kanë lidhje me thirrjen dhe drejtimin e mbledhjes së ortakëve;
- l. publikimin e shpalljeve të nevojshme përfshirë dhe publikimin e pasqyrave vjetore financiare;
- m. administratori është përgjegjës për mbajtjen e rregullt dhe ruajtjen e dokumentacionit të Shoqërisë;

15.6 Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme.

15.7 Personi i mëposhtëm do të caktohet administrator për një periudhë 5 (pese) vjeçare me të drejtë ripërtëritjeje:

Z. Realdo Mansaku, shtetas shqiptar, lindur më 31.03.1987 në Tiranë dhe banues në Tiranë, Shqipëri, mbajtës i letërnjoftimit nr. 033575520 dhe Nr. personal I703310600, madhor dhe me zotësi te plote juridike për te vepruar.

PJESA VI

VITI FINANCIAR, BILANCI, FITIMI DHE HUMBJET




Neni 16

Viti financiar, pasqyrat vjetore financiare

- 16.1 Viti financiar i Shoqërisë zgjat 12 muaj dhe fillon në ditën e parë të Janarit dhe mbaron në ditën e 31 (tridhjetë e një) të Dhjetorit. Viti i parë financiar i Shoqërisë fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë dhe mbaron në datën e 31 (tridhjetë e një-te) të Dhjetorit.
- 16.2 Në fund të cdo viti financiar, administratori do të përmbushi detyrat e mëposhtme:
- përgatitjen e një liste të detajuar të aseteve të Shoqërisë;
 - përgatitjen e bilancit të shoqërisë i cili përshkruan situatën financiare të Shoqërisë;
 - përgatitjen e llogarive të fitimit dhe të humbjeve.
- 16.3 Pasqyrat financiare vjetore, inventari, raporti i Administratorit dhe ekspertit kontabël te autorizuar, nëse ka një të tillë, miratohen nga Asambleja e Përgjithshme ne përputhje me legjislacionin ne fuqi.

PJESA VII

PRISHJA DHE LIKUIDIMI

Neni 17

Prishja dhe likuidimi

- 17.1 Shoqëria do të priset në rastet e mëposhtme:
- vendim i mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme;
 - bashkimi me një shoqëri tjetër;
 - vendimi i gjykatës me juridiksion përkatës në rastet e parashikuara me ligj;
 - në të gjitha rastet e tjera të parashikuara me ligj.
- 17.2 Prishja e Shoqërisë do te shoqërohet me likuidimin e saj. Likuidimi i Shoqërisë dhe shpërndarja e aseteve të Shoqërisë do të bëhet në përputhje me parashikimet ligjore ne fuqi.
- 17.3 Asambleja e Pergjithshme do te emëroje një ose me shume likuidues, dhe do te përcaktoje tagrat e tyre ne përputhje me parashikimet e legjislacionin ne fuqi.
- 17.4 Shoqëria vazhdon se ekzistuari si person juridik vetëm ne kuptim te likuidimit deri ne përfundim te tij dhe gjate likuidimit togfjalëshi “*ne likuidim e sipër*” duhet te vihet pas emrit te Shoqërisë.

PJESA VIII

DISPOZITAT FINALE



Neni 18

Ligji i zbatueshëm dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve


- 18.1 Ky statut bazohet ne legjislacionin shqiptar, interpretimi, vlefshmëria dhe zbatimi i tij, do te kryhen ne përputhje me parashikimet e legjislacionit shqiptar. Persa nuk është parashikuar këtu, do te zbatohen dispozitat e Ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 “Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare”, te ndryshuar.
- 18.2 Në rast mosmarrëveshjes të cilat lindin midis ortakeve apo midis ortakeve dhe shoqërisë, si pasojë e këtij Statuti ose për shkak të ligjit, ortakët do të përpiqen t’i zgjidhin ato miqësisht. Nëse nuk arrihet një marrëveshje, mosmarrëveshja e ortakëve do të zgjidhet nga gjykata me juridiksion përkatës.

Ky Statut hartohet dhe nënshkruhet në 3 (tre) kopje origjinale ne gjuhen shqipe.

ORTAKET



Z. Realdo MANSAKU





Z. Florian MITRUSHI



Tiranë 26.10.2021

SPECIMEN NENSHKRIMI

Te nderuar,

Unë i nënshkuari **Realdo Manksaku**, shtetas shqiptar, lindur me **31.03.1987**, ne **Tirane**, mbajtës i letërnjoftimit me Nr. 033575520 dhe Nr. Personal **I703310600**, , deklaroj se pranoj detyrën e re Administratorit te Shoqërisë me përgjegjësi te kufizuar, me emërtimin “**ENERGY DEVELOPMENT PARTNERS**”, qe do te regjistrohet pranë regjistrit tregtar shqiptar, dhe nënshkrimi qe une do te përdor per këtë Shoqëri do te jete vijuesi.

Nënshkrimi

Realdo Manksaku

Realdo Manksaku

